



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:087886

Datë: 12.01.2022

Numri i dokumentit: 02596662

A.nr.1026/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit NT[“S...”] me seli në Prizren kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 10.01.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet Kërkesëpadia e paditësit NT[“S...”] me seli në Prizren, si e pabazuar

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/5009-2019 datës 24.03.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura në rivendosje, ka refuzuar kërkesën e paditësit, për rishqyrtimin e vendimit DUD R-8874 të datës 04.04.2019, me të cilin vendim i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim në zyrën doganore Prizren, si e pabazuar.

Paditësi NT[“S...”] me seli në Prizren me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 07.05.2021, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e padisë si të bazuar, të anulohet në tërësi vendimi nr.01.3.2.2/5009-2019 i datës 24.03.2021 i të paditurës, dhe paditësit t’i kthehen mjetet e paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të mallit nga ana e Doganës së Kosovës në shumë prej 1,255.13€.

Në padinë e tij dhe përmes të autorizuarit në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaroi: me anë të Deklaratës doganore R-8874/04.04.2019 në ZBD Prizren, importuesi ka deklaruar për doganim mallin: granulat prej gome për fusha sportive-me detajisht sipas faturës dhe deklaratës doganore. Me rastin e deklarimit të këtij malli ka poseduar të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për të bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit. Mirëpo këto dokumente nuk janë marrë parasysh nga zyrtarët doganor të cilët kanë kontestuar vlerën e këtij e mallit dhe e kanë rivlerësuar atë me metodën e dytë të rivlerësimit apo të dhënave të çmimeve për mallrat identike nga të dhënat e disponueshme në bazë të zhdoganimeve të mëhershme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: mbetem në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave lidhur me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009, pasi që paditësi DUD-it kontestues i ka bashkangjitur dokumente relevante, për të vërtetuar çmimin e transaksionit, sikurse janë:

pro fatura, pagesa bankare në emër të saj, fatura e mallit, deklarata eksportuese dhe fatura e shpenzimeve të transportit. Siç mund të shihet nga pagesa pangare, e njëjta është realizuar në emër të pro faturës, pastaj malli është shoqëruar me faturën e cila ka një vlerë më të vogël prej 5.75.00 euro, për shkak të pa mundësisë së ngarkimit të gjithë mallit porositur. Por çmimi për kg. është i njëjtë, dhe është një vlerë e vogël e mos përputhjes dhe e pallogaritshme në aspektin financiar për paditësin. E paditura konsiderojmë se ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike me rastin e krahasimit të çmimit të mallit me DUD-at referues 23272 dhe 22188, të cilat janë deklaruar për import nga Federata e Futbollit të Kosovës, pasi që siç mund të shihet nga të dhënat e këtyre DUD-ve, mallrat e importuara nga FFK janë liruar nga detyrimet doganore, pra nuk kanë paguar taksa sikurse paditësi, dhe si të tilla të dhënat e këtyre DUD-ve, nuk mund të jenë objektive pasi që edhe malli është donacion për FFK-në, dhe vlera e shënuar në DUD-in nuk paraqet çmim të transaksionit sepse të njëjtin DUD nuk e ka paguar askush. Prandaj konsiderojmë se dokumentacioni i paditësit i theksuar më sipër pasqyron në mënyrë reale vlerën e mallit, e cila është paguar përmes Bankës. Po ashtu DUD-i tjetër referent nr.14155, dt.22.03.2019, i importuesit NTT ["G..."] po ashtu është i rivlerësuar në metodën e 6-të dhe si i tillë as ky DUD nuk mund të merret për bazë për krahasimin e çmimit, Për shkak të rivlerësimit paditësi ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 1,255.13 Euro, e cila kërkon ti kthehet së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8%, nga data e pagesës e deri në kthimin e plotë.

E paditura në përgjigjen në padi datës 02.12.2021 deklaroi: e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Me aktvendimin e kontestuar nr. 01.3.2.2/5009/2019 të datës 24.03.2021 të Doganës së Kosovës është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i propozojm gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se e paditura me parashtrësën e datës 06.01.2022 ka njoftuar gjykatën se nuk mund të marr pjesë në seancën gjyqësore dhe propozon që të veprohet konform nenit 38.5 të LKA-së (provë: parashtrësja e datës 06.01.2022 nga Dogana e Kosovës).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 10.01.2022, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.02.12.2021, e Doganës së Kosovës, aktvendimi 01.3.2.3/5009/2019, i dt. 24.03.2021 i Doganës së Kosovës, aktvendimi 01.3.2.2/8874, i dt. 22.05.2019, i Doganës së Kosovës, deklaratat doganore, pro fatura, nr.0001/2019, pagesa Bankare dt.27.03.2019, fatura e mallit nr.1654, deklarata eksportuese e dt.03.04.2019, fatura e shpenzimeve të transportit, faturat e dt. 25.04.2019, 30.04.2019, 15.05.2019, Aktgjykimi A.nr.1566/19, i dt.15.02.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të dt. 04.04.2019 dhe 26.03.2019, ankesa e paditësit me nr.prot. 5009/19, i dt.19.04.2019, DUD-at referues të Doganës.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe konstatoi se kërkespadia është e pa bazuar.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura në rivendosje, ka sqaruar për gjykatën se Sektori i Pranimit Qëndror, ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sepse është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar për mallin e shitur për eksport në vendin tonë. E paditura konfirmon rivlerësimin

e mallit ku malli lëndor është rivlerësuar sipas metodës së vlerësimit neni 34.2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme nga të dhënat e vlerës së transaksioneve të mallrave identike, duke u referuar në zhdoganimet e mallit me DUD-at R22188/26.04.2019, R23272/01.05.2019, R26726/16.05.2019. E paditura ka vlerësuar se para dhe pas importit kontestues nga i njëjti eksportues çmimi fatural i mallit lëndor rezulton të jetë më i ulët në raport me faturat tjera të lëshuara nga eksportuesi i njëjtë.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Paga banka e datës 04.04.2019 e realizuar në Raiffeisen Bank, në vlerë prej 2,760,00€ që gjendet në shkresat e lëndës nuk është e harmonizuar me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr.RE 1654 dt.04.03.2019 të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore nr.R-8874/04.04.2019 të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren, pasi që fatura e mallit ka shumën prej 2,754.25€. Nga një mos harmonizim i tillë i vlerës së dokumentacioneve të paraqitura nga pala paditëse, gjykata pranon konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar për të vërtetuar vlerën reale të mallit.

Prandaj gjykata konstaton se paditësi nuk ka qenë në gjendje që ti provoj me argumente të bazuara pretendimet se ka paraqitur dokumentacionin e duhur dhe të harmonizuar sipas të cilit do të duhej që e paditura Dogana e Kosovës ta vlerësonte mallin lëndor sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës posedon të dhënat e disponueshme nga transaksionet identike apo të ngjashme në periudhë të afërt kohore nga i njëjti furnizues i mallit dhe i njëjti shtet eksportues kur është zhdoganuar malli lëndor kontestues si: DUD-at R22188/26.04.2019, R23272/01.05.2019, R26726/16.05.2019. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 34.2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor.

Nga provat e administruara gjykata nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit, prandaj gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga Sektori i Pranimit Qëndror, duke aplikuar metodën e 2 të vlerësimit neni 34.2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht transaksioneve të mallrave identike.

Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e mjaftueshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.01.3.2.2/5009-2019 datës 24.03.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal  
A.nr.1026/21 datë 10.01.2022

Gjyqtari,  
Krenar Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.